

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

**Aktiviteti 2.6.1: Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të
Veprimit me fokus në SUT**

Komponenti nr 2 Llogaritë Kombëtare

Misioni i udhëhequr nga
Søren Larsen,
Statistikat e Danimarkës

22-26 Qershor 2015

IPA 2012

*Søren Larsen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +45 39 17 39 83
Email: shl@dst.dk*

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
1. Komentet e përgjithshme.....	5
2. Vlerësimi dhe rezultatet.....	6
2.1 Korniza e SUT.....	6
2.2 Zgjedhja e klasifikimeve.....	6
2.2.1 Të dhënat e nevojshme për industrinë dhe përdorimi final.....	6
2.2.2 Klasifikimi i produkteve.....	7
2.2.3 Klasifikimi i industrisë për produkte, konsum të ndërmjetëm dhe komponentet e bruto vlerës së shtuar.....	7
2.2.4 Klasifikimet e konsumit final.....	7
2.3 Burimet e të dhënave. Korrespondenca në mes klasifikimeve në burime të të dhënave dhe SUT....	8
2.3.2 Tregtia e jashtme e mallrave.....	8
2.3.3 Tregtia e jashtme e shërbimeve.....	8
2.3.4 Bujqësia.....	8
2.3.5 Minierat, prodhimi, energjia, gasi dhe ngrohja.....	8
2.3.6 Industrinë e shërbimit të mbuluara nga ASN dhe/ose statistikave të TVSH-së.....	10
2.3.7 Institucionet jo-profitabile që i shërbejnë ekonomive familjare (NPISH).....	10
2.3.8 Qeveria e përgjithshme.....	10
2.3.9 Shërbimet që nuk janë të mbuluara nga ASN ose statistikave të TVSH-së.....	10
2.3.10 Konsumi final i ekonomive familjare.....	10
2.3.11 Në përgjithësi, ekonomia e pavrojtuar.....	11
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	11
Termat e Referencës:	11

Lista e Shkurtesave

ESA 95	Sistemi Evropian i Llogarive 95
ESA 2010	Sistemi Evropian i Llogarive 2010
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
LLK	Llogaritë Kombëtare
NACE rev.1	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 1
NACE rev.2	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike, rev. 2
DLLK	Departamenti i Llogarive Kombëtare
R&D	Kërkimi dhe Zhvillimi
ASN	Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve
SUT	Tabelat Ofruese-Përdoruese
TeR	Termat e Referencës

Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij misioni ishte përgatitja e burimeve të të dhënave për tu futur në kornizën e SUT për vitin 2013. Pasi në kohën e misionit nuk ishin në dispozicion disa burime të rëndësishme statistikore, është bërë një ndryshim në planin e aktiviteteve për këtë projekt.

Tashmë është hartuar një version i kornizës për tabelat ofruese përdoruese në formë Excel-i, për nivelet e çmimeve, nga çmimet bazë deri tek çmimet e blerjes. Për këtë ishte e nevojshme të merren disa vendime në lidhje me numrin e industrive, grupet e konsumit dhe klasifikimet e përdorimit final, që do të paraqitet në kolona. Versioni aktual bazohet në versionin NACE rev.2 dy shifror dhe versionin COICOP dy shifror.

Në misionin e mbajtur në Mars 2015 është hartuar versioni i parë i klasifikimit të mundshëm të produkteve, që do të përdoret në SUT. Kryesisht është i bazuar në statistikën e detajuar të TVSH-së për vitin 2013. Më pas outputi i bujqësisë nga llogaritë kombëtare ekzistuese është koduar nga klasifikimi i propozuar i produkteve dhe është sjell në një format të standardizuar, që do të përdoret për futjen e të dhënave nga Excel-makros.

Kur korniza e Excelit që përmban SUT bazohet në disa rregulla specifike, pjesa e brendshme e sistemit mund të arrihet nga sistemi makros që është zhvilluar në kuadër të Statistikave të Danimarkës. Makros janë përdorur për futjen e të dhënave, nxjerrjen dhe balancimin e balanceve të produkteve. Në këtë moment tabelat e Excelit janë ende të zbrazta, por do të plotësohen me të dhëna pasi të jenë transformuar burimet në një format të standardizuar dhe të koduar.

Kur përpilimi i SUT të arrijë në fazën finale, makros do të realizojë shumicën e korrigjimeve që janë të nevojshme për të balancuar anën ofruese dhe përdoruese të tregtisë – dhe marzhat e transportit, taksat mbi produktet dhe TVSH-në.

Gjatë misionit aktual, personat që janë përgjegjës për burimet e ndryshme të të dhënave, kanë filluar kodimin e të dhënave të tyre përkatëse sipas versionit aktual të klasifikimit të produkteve. Me siguri do të duhet të bëhen reduktime të numrit të produkteve, duke pasur parasysh informacionet e mangëta. Kodimi i burimeve të të dhënave në dispozicion pritet të përfundojë para misionit të radhës.

Cilësia e SUT do të varet nga disponueshmëria e të dhënave për vitin 2013. Disa të dhëna të rëndësishme, ASN- dhe statistikën PRODCOM nuk pritet të jenë në dispozicion deri në mes të Shtatorit. Prandaj duhet të ndryshohen afatet kohore të parapara për aktivitetet.

Siç është cekur në raportin e misionit të mbajtur në Mars, suksesi i projektit do të varet nga disponueshmëria e burimeve njerëzore në ASK, pasi shumë punë duhet të kryhen gjatë periudhës kohore midis misionëve. Aktualisht stafi është duke punuar në kodimin e të dhënave në kuadër të fushave të tyre të përgjegjësisë. Statistikat e ASN-së për vitin 2012 janë koduar në Danimarkë, për arsye të disa komplikimeve, që janë paraqitur për shkak të nevojës për t'i transferuar manualisht produktet në SUT-produkte si dhe industrinë në SUT-industri të reja, bazuar në kodet e vjetra NACE rev.1.1.

Pritet që të dhënat nga këto burime të jenë të gatshme të futen në kornizë në fillim të misionit të radhës.

1. Komentet e përgjithshme

Gjatë misionit të mbajtur në Mars 2015, është vendosur të fillojë puna mbi tabelat ofruese-përdoruese për vitin 2013. Qëllimi i misionit aktual ishte kodimi, sa më shumë që është e mundur, i burimeve të të dhënave në dispozicion nga klasifikimet e produkteve, transaksioneve, industrive dhe grupeve të konsumit, që janë zgjedhur për versionin fillestar të matricës për SUT.

Për këtë qëllim, nevojiten tabelat korresponduese midis kodeve të përdorura në burimin e të dhënave dhe kodeve të përdorura për SUT. Pas këtij aktiviteti me siguri do të ketë një rishikim të disa propozimeve fillestare të klasifikimeve. Megjithatë, duket që në shumicën e rasteve është e mundur të transformohen të dhënat në klasifikimet e propozuara.

Burimet e të dhënave, që nevojiten për përpilim, tashmë janë të gatshme për disa fusha, si tregtia e jashtme e mallrave, statistikat e bujqësisë, statistikat e tatimit të vlerës së shtuar, anketa e buxhetit të ekonomive familjare dhe të dhënat e financave qeveritare për vitin 2013. Personat, që janë përgjegjës për secilën fushë, tani janë duke punuar në përkthimin e kodimit në kodet e produkteve të SUT. Një përkthim i ngjashëm mund të bëhet edhe me kodet e industrisë dhe konsumit, pasi burimet e të dhënave përmbajnë klasifikimet e nevojshme NACE, COICOP dhe COFOG. Kjo punë pritet të përfundojë para misionit të radhës.

Disa burime të të dhënave ende nuk janë në dispozicion. Ekzistojnë statistikat e ASN-së për vitin 2013, por ende nuk janë të kompletuara. Për të plotësuar këtë mungesë, është e mundur të përdoren strukturat nga statistikat e ASN-së për vitin 2012 dhe ky burim tashmë është duke u koduar me klasifikimet e SUT për vitin 2013. Struktura e produktit e outputit të industrisë dhe – inputet duhet të bazohen në statistikat e reja PRODCOM për vitin 2013, që tashmë janë duke u procesuar dhe pritet të jenë të gatshme në mes të Shtatorit.

Është shqyrtuar nëse statistikat e ASN-së të vitit 2014 mund të përdoren për t'i plotësuar informacionet mbi strukturën në kuadër të industrive, që nuk mbulohen mirë nga statistikat e ASN-së për vitin 2013. Megjithatë, nuk është e sigurt nëse do të jenë të gatshme në kohë dhe aktualisht për këtë qëllim. Më reale duket përdorimi i ASN-së të vitit 2012.

Propozimi për afatet kohore të aktiviteteve për projektin SUT është paraqitur në raportin e misionit të marsit. Pasi pritet që statistikat PRODCOM për vitin 2013 dhe versioni final i të dhënave të ASN-së për vitin 2013 të jenë të gatshme në mes të Shtatorit, nuk mund të krijohet versionit fillestar i tabelës ofruese para fillimit të Tetorit. Kjo duhet marrë parasysh gjatë planifikimit të misioneve të tjera.

Konsulentët dëshirojnë të falenderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e tyre gjatë qëndrimit në Kosovë.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e praqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës dhe partnerëve tjerë (NI-C)/Statistikat e Finlandës/Istat/ Statistikat e Lituanisë).

2. Vlerësimi dhe rezultatet

2.1 Korniza SUT.

Është krijuar një kornizë e zbrazët për SUT, në Statistikat e Danimarkës. Makros për futjen dhe ekstraktimin e të dhënave nga sistemi, si dhe makros për balancimin e anës ofruese dhe përdoruese, rregullimin e objektivave për inputet, konsumit final dhe përdorimet e tjera finale janë në dispozicion veçmas. Makros të tilla janë zhvilluar në Statistikat e Danimarkës dhe më herët janë përdorur në përpilimin e SUT në vende të tjera.

Sistemi SUT kërkon definimin e klasifikimeve përfundimtare për produktet, industritë, grupet e konsumit dhe nën grupet e formimit të kapitalit. Në versionin aktual të kornizës SUT ato janë definuar nga lidhjet e tyre me klasifikimet ndërkombëtare zyrtare CPA, NACE, COICOP dhe COFOG. Zgjedhja e klasifikimeve përcakton dimensionet e tabelave në Excel.

Është hartuar klasifikimi përfundimtar i produkteve. Secili produkt është definuar si një total i produkteve i përfaqësuar nga CPA-kodet specifike. Niveli i totalit ndryshon në mes kategorive të produkteve, që reflektojnë diferencat e rëndësisë së tyre në SUT për Kosovën, dhe po ashtu, deri në një masë, disponueshmërinë e informacioneve.

Përdorimi i plotë i kornizës së Excel-it kërkon që burimi i të dhënave të jetë në një format të standardizuar, duke përdorur klasifikimet mirë të definuara për produktet, llojet e transaksionit, industritë dhe përdorimin final. Inputet nga burimet e ndryshme të të dhënave do të jenë të klasifikuara sipas sistemeve të ndryshme të kodimit. Do të jetë e domosdoshme të vendosen tabelat korresponduese midis secilit prej këtyre klasifikimeve, që përdoren në SUT.

2.2 Zgjedhja e klasifikimeve.

2.2.1 Të dhënat e nevojshme për industritë dhe përdorimi final.

SUT do të kërkojë për secilën industri, minimalisht të mëposhtmet:

- Vlerat për outputin total
- Konsumin e ndërmjetëm
- Kompenzimin e punëtorëve

Vlerat për këto industri në total do të futen në kornizën Excel si ‘objektiva’ për totalin e kolonave korresponduese. Ngjashëm, një grup fillestar i ‘objektivave’ për totalin e kolonave për përdorim final duhet të kalkulohet prej burimit të të dhënave.

Vlerat aktuale të totalit të kolonave mund të jenë ndryshe nga vlerësimet fillestare. Objektivat e kolonave mund të vlerësohen me pak a shumë siguri. Objektivat e industrisë, që janë si rezultat i kalkulimeve të bazuara në statistikat e besueshme të llogarive, zakonisht mund të konsiderohen të besueshme në krahasim me p.sh. objektivat për grupet e konsumit që janë kalkuluar duke përdorur të dhënat nga anketa e buxhetit të ekonomive familjare, që janë të dhëna nga mostra dhe të peshuara për të përfaqësuar ekonominë në tërësi. Si rregull i përgjithshëm, balancimi duhet të sigurojë që totalët e kolonave aktuale plotësojnë objektivat

për ato përdorime, që konsiderohen si të besueshme, përderisa pranohet që ato të ndryshojnë prej objektivave më pak të besueshme.

2.2.2 Klasifikimi i produkteve.

Zgjedhja fillestare e klasifikimit të produkteve është rezultat i kodimit bazuar në statistikën e detajuar të TVSH-së për vitin 2013. Qarkullimi sipas industrive mund të gjendet i klasifikuar sipas industrive NACE 4 shifror. Si pikë nisje supozohet se për shumicën e industrive njësitë e vogla prodhojnë vetëm produktet, që janë output karakteristik i industrisë. Pasi ekziston një korrespondencë e afërt midis CPA-klasifikimit të produkteve dhe NACE klasifikimit të industrive në këtë nivel, një shpërndarje e ndjeshme fillestare e outputeve sipas produkteve mund të vendoset për industrinë NACE dy shifrore, përderisa produktet janë të përcaktuara sipas CPA-kodeve në nivel 4 shifror ose më ulët. Në këtë mënyrë, mund të arrihen rreth 370 produkte. Ky klasifikim me siguri është shumë i detajuar dhe disa produkte do të duhet të bashkohen pas krahasimit me klasifikimet e përdorura në strukturat e burimeve të të dhënave, konsumit final të ekonomive familjare dhe konsumit të përgjithshëm të qeverisë.

Megjithatë, është mëse e qartë që vlerat e qarkullimit nga TVSH-ja do të zëvendësohen sa më shumë që është e mundur me informacione nga statistikën e ASN-së, sidomos për ndërmarrjet e mëdha.

2.2.3 Klasifikimi i industrisë për prodhim, konsum të ndërmjetëm dhe komponentet e bruto vlerës së shtuar.

Zgjedhja e klasifikimit që përdoret për kolonat e outputit-dhe inputit me siguri mund të kufizohet midis mes 64-ose 86 industrive ose një kompromis midis këtyre dyjave. Derisa 86 industri korrespondojnë me NACE rev.2 2 shifror, 64 klasifikime të industrisë janë ato që kërkohen nga Programi i Transmetimit i BE-së, dhe për krahasime ndërkombëtare në përgjithësi. Për qëllime të I-O mund të preferohet një klasifikim më i detajuar, por industrinë më pak të detajuar mund të jenë më të realizueshme në rastet kur burimet e të dhënave janë të pamjaftueshme dhe të pasigurta.

2.2.4 Klasifikimet e konsumit final.

Vlerësimet fillestare të detajuara të përdorimit të produkteve për konsumin final të ekonomive familjare mund të merren nga anketa e buxhetit të ekonomive familjare për vitin 2013. Mund të përdoren vlerat e peshuara, që përfshijnë konsumin nga popullata në përgjithësi.

Anketa është e klasifikuar sipas COICOP 5 shifror, që duhet të jetë mjaftueshëm e detajuar që të përkthehet në produktet SUT. Aktualisht korniza paraqet konsumin e ekonomive familjare si COICOP-grupe 2 shifrore (plus 2 kolona për konsumin e rezidentëve jashtë vendit dhe jo-rezidentëve në territorin e brendshëm).

Konsumi final i NPISH paraqitet si një kolonë e vetme. Është e mundur të ndahet nga COICOP-grupet, por shpërndarja e tij sipas produkteve mund të paraqesë informacione të ngjashme. E njëjta aplikohet për konsumin individual të qeverisë së përgjithshme. Aktualisht është zgjedhur ndarja e konsumit të qeverisë në kolona për COFCOG grupet 2 shifrore (=divizionet). Konsumi individual mund të paraqitet sipas grupeve COICOP.

Formimi Bruto i kapitalit Fiks duhet të ndahet sipas llojeve të aseteve fikse të detajuara siç kërkohet nga programi i transmetimit ESA 2010. Ndryshimet në inventar mund të paraqiten

në kolonën e materialeve, produkteve të përfunduara, punës në progres dhe mallrave për tregti.

2.3 Burimet e të dhënave. Korrespondenca midis klasifikimeve në burimet e të dhënave dhe SUT.

2.3.2 Tregtia e jashtme e mallrave.

Statistikat për vitin 2013 janë të koduara detajisht nga HS. Parimisht shumica e përkthimit në CPA mund të bëhet në mënyrë automatike, me tabelën korresponduese. Duke përdorur lidhjen në mes CPA dhe produkteve në SUT, është krijuar tabela korresponduese midis HS dhe produkteve të SUT. Megjithatë, përdorimi i kësaj table korresponduese ka rezultuar me një numër produktesh, që nuk përputhen, dhe duhet të kodohen manualisht. Ky kodim ka filluar gjatë misionit dhe pritet të përfundojë para fillimit të misionit të radhës.

2.3.3 Tregtia e jashtme e shërbimeve.

Aktualisht janë në dispozicion vetëm dy shifra, eksporti total dhe importi total. Nuk është e qartë si është bërë tranzicioni CIF-FOB. Nevojiten informata shtesë për këtë. ASK do të kontaktojë Bankën Qendrore për të marrë sa më shumë informata të detajuara që është e mundur mbi kalkulimet prapa shifrave. Për këtë qëllim, mund të jetë i dobishëm caktimi i një takimi me zyrtarë të Bankës Qendrore.

Duhet të ndajmë shifrat e importit dhe eksportit për shërbime në produkte-shërbime, që i kemi definuar për SUT – nëse e nevojshme duke përdorur supozime.

2.3.4 Bujqësia.

Prodhimi në bujqësi mund të gjendet në ‘Llogaritë Ekonomike për Bujqësi 2013’, që përmban specifikacionin e outputit sipas produkteve të ndryshme bujqësore. Po ashtu, përmban informacione mbi inputet e importit në bujqësi. Kodimi i outputit ka filluar në Mars, por ende nuk ka përfunduar. Ekspertët danezë do të shikojnë kodimin e inputeve para se të fillojë misioni i radhës.

2.3.5 Miniera, prodhimi, energjia, gazi dhe ngrohja.

Statistikat e TVSH-së për vitin 2013 janë në dispozicion në NACE, nivel 4 shifror. Këto përmbajnë informata në lidhje me qarkullimin dhe blerjet, kjo e fundit e nënndarë në blerjet për konsum të ndërmjetëm dhe blerjet për qëllime investimi. Statistikat duket të kenë një mbulueshmëri të mirë, por vështirë se mjaftojnë për përshkrimin e strukturave të outputit sipas produkteve, pasi nuk përmbajnë asnjë informatë mbi shitjet e pajisjeve kapitale të përdorura ose prodhimit sekondar. Është e rëndësishme që statistikat e TVSH-së të plotësohen me informatat e mbledhura nga ASN-ja.

Statistikat e ASN-së do të sigurojnë informata mbi prodhimin sekondar në kuadër të ndërmarrjeve të mëdha. Kur prodhimi sekondar merrë formën e tregtisë, vlerës së qarkullimit duhet ti hiqet blerja e mallrave për rishitje, dhe diferenca midis shitjes dhe blerjes të këtyre mallrave duhet të kodohet si output i shërbimeve të tregtisë, që shpërndahen kryesisht si marzha të tregtisë. Prandaj, statistikat e TVSH-së do të ekzagjerojnë vlerën e outputit në industrinë me aktivitete tregtie.

Mund të supozohet që në shumë industri njësitë e vogla, që nuk mbulohen nga ASN, prodhojnë një produkt të vetëm të SUT, që është output karakteristik i industrive të tyre NACE 4 shifror.

Thuhet që ka pak ndërmarrje të mëdha. Për ndërmarrje të tilla, madhësia e aktiviteteve sekondare mund të gjendet në ASN dhe ndarja e outputit total me siguri mund të përmirësohet duke përdorur statistikën PRODCOM, kur ato të jenë në dispozicion. Si burim i fundit është e mundur të mbledhen informata shtesë nga disa ndërmarrje të mëdha dhe këto informata jo domosdoshmërisht duhet të jenë të vitit 2013.

Inputet në industritë e mbuluara nga ASN me siguri mund të përdorin informata në këto statistika, edhe nëse mbulueshmëria e tyre nuk është e kënaqshme. Të dhënat e ASN-së të vitit 2012 mund të përdoren për të përshkruar strukturat e inputit në situatën kur mungojnë të dhënat e ASN-së për vitin 2013.

Në përgjithësi mund të supozohet që të dhënat mbi strukturat e inputit të industrive nuk janë tërësisht të kompletuara, por është e mundur të përdoren informata shtesë mbi inputet nga vitet e mëhershme ose të mëvonshme, nga vendeve e tjera dhe në shumicën e rasteve nga praktika e zakonshme. Në fund, shumë inpute do të përcaktohen nga oferta në dispozicion për përdorim të brendshëm.

Statistikat PRODCOM pritet të ofrojnë një përshkrim më të mirë të strukturës së produkteve të outputeve dhe inputeve në industritë e prodhimit, kur janë në dispozicion.

Për produkte specifike është e mundur të përcaktohet përdorimi i tyre si konsum i ndërmjetëm, konsum final i ekonomive familjare ose formim i kapitalit nga karakteristikat e tyre. Kjo metodë e 'rrjedhës së mallrave' është megjithatë e pasigurt, ku produktet e njëjta zakonisht përdoren për më shumë se një nga këto përdorime. Prandaj, preferohet që strukturat fillestare të produktit të ndërtohen për të gjitha kolonat në anën përdoruese të SUT, por gjatë procesit të balancimit dikush mund të preferojë t'i rregullojë vlerat, që janë më të pasigurta.

Aktualisht statistikën e TVSH-së janë në dispozicion për vitin 2013, në versionin që përmban variablat, që do të përdoren për SUT.

Statistikat e ASN-së për vitin 2012 tashmë janë në dispozicion në tabelë me të gjitha variablat e tyre. Megjithatë, janë të klasifikuara sipas klasifikimit të vjetër NACE rev.1.1 dhe informatat mbi produktet nuk ofrojnë specifikacione, që mund të përkthehen drejtpërdrejt në produkte të SUT. Eksperti është duke punuar në përkthimin e këtyre informatave në klasifikimet, që përdoren në SUT. Duket që informatat e kombinuara në NACE rev.1.1 4 shifror dhe kategoritë e produkteve mjaftojnë për këtë qëllim, por kodimi duhet të bëhet manualisht. Kjo detyrë do të përfundojë para misionit të radhës.

Një kodim i ngjashëm i ASN-së për vitin 2013 duhet të jetë më pak i komplikuar pasi kjo anketë është e klasifikuar sipas NACE rev.2. Megjithatë, kërkohet që kodet e këtyre produkteve të përkthehen në një gjuhë që kuptohet. ASK duhet të bëjë një përkthim të titujve (ngjashëm me përkthimet e titujve në ASN-2012). Eksperti pastaj do të shikojë se si mund të bëhet kodimi për qëllime të SUT.

2.3.6 Industritë e shërbimeve të mbuluara nga ASN dhe/ose statistikat e TVSH-së.

Ajo që i tha më lart për industrinë e prodhimit vlen edhe për industrinë e shërbimeve, që mbulohen nga TVSH dhe statistikat e ASN-së. Këtu strukturat e produkteve me siguri do të duhet të bazohen vetëm në kodimin NACE në shumë industri.

2.3.7 Institucionet jo-profitabile që i shërbejnë ekonomive familjare (NPISH).

Statistikat që paraqesin inputin, kompenzimin e punëtorëve, taksat dhe subvencionet mbi prodhimin, të ardhurat dhe investimet, janë në dispozicion në Excel. Pasi këto paraqesin një shpërndarje të plotë sipas organizatave të ndryshme, duhet të jetë e mundur të kodohet outputi i secilës nga industrinë relevante dhe kodet e outputit. Informatat mbi inputet janë të pamjaftueshme, por strukturat produkteve të tyre mund të vlerësohet bazuar në p.sh. strukturat e ngjashme të inpueteve në kuadër të qeverisë së përgjithshme. Kodimi akoma nuk ka filluar.

2.3.8 Qeveria e përgjithshme.

Inputi në qeverinë e përgjithshme është i koduar në mënyrë sistematike sipas llojit të produktit. Ndërtimi i tabelës korresponduese midis këtij kodimi dhe kodeve të produkteve, që do të përdoren në SUT, është në vazhdim e sipër dhe pritët të përfundojë para misionit të radhës.

Shpenzimet e tjera si pagat dhe medijet, dhe taksat neto mbi prodhimin, duhet të kodohen sipas kodeve të transaksioneve. Totalët për outpute dhe inpuete pastaj mund të kalkulojnë si shumë e kostove sipas qëllimit (industrive). Ndoshta duhet të bëhen disa vlerësime të konsumit të kapitalit fiks për të përfunduar kalkulimin e prodhimit të qeverisë.

Ky dallim në mes konsumit individual dhe kolektiv me siguri mund të përcaktohet nga lloji i shërbimeve të qeverisë. Kjo do të vendoset gjatë misionit të radhës.

2.3.9 Shërbimet që nuk mbulohen nga ASN dhe statistikat e TVSH-së?

Statistikat e TVSH-së duket që kanë mbulueshmëri të madhe në fushat e qarkullimit, të liruar nga TVSH. Sidoqoftë, duhet të shikohet nëse ka shërbime që nuk mbulohen nga asnjë nga burimet e të dhënave, të përmedura më parë, dhe në këtë rast vlerësimet duhet të improvizohen në mënyra tjera.

2.3.10 Konsumi final i ekonomive familjare.

ABEF për vitin 2013 është në dispozicion në formë tabele, e koduar detajisht sipas COICOP, dhe e peshuar me qëllim që të përfaqësojë tërë popullatën. Prandaj, objektivat fillestare për totalët e kolonave për grupet COICOP 2 shifror mund të kalkulojnë lehtë. Konvertimi i të dhënave në strukturat e produkteve për secilin nga këto grupe është më i vështirë. Tabela korresponduese që paraqet lidhjen midis COICOP 4 shifror dhe CPA ka rezultuar të jetë më pak e saktë se sa duhet. Prandaj, duket që shumica e përkthimit në produkte të SUT duhet të bëhet në mënyrë manuale.

Tashmë ka filluar përkthimi në produkte të SUT. Ndoshta duhet të caktohet më shumë se një person për këtë detyrë, pasi duket se merr shumë kohë dhe është e rëndësishme që të dhënat të jenë të gatshme të futen në kornizën SUT në fillim të misionit të radhës.

2.3.11 Mbulueshmëria, ekonomia e pavrojtuar.

Në përgjithësi besohet që Kosova ka një ekonomi të pavrojtuar sinjifikante. Idealisht, do të duhej të kishte një qasje sistematike e vlerësimit të saj p.sh. bazuar në numrin e personave që marrin pjesë në prodhim, që nuk mbulohet nga asnjë prej burimeve të përdorura për vlerësimin e ekonomisë formale, dhe të ardhurat mesatare nga aktivitete të tilla.

Duhet të merret në konsideratë, që vlerësime të tilla të bëhen së paku për fusha, që dihet se përbëjnë një pjesë të madhe të prodhimit të pa deklaruar. Një qasje tjetër është të krahasohen vlerat e kalkuluara, që janë në dispozicion nga ana përdoruese, me vlerat që janë në dispozicion nga ana ofruese. Aty ku ka mospërputhje dhe mungesë në anën ofruese, mund të jetë që ka aktivitet jo formal, që duhet t'i shtohet shifrave të prodhimit.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Gjatë misionit është filluar të punohet në ato fusha, për të cilat ekzistojnë të dhënat e nevojshme. Janë kompletuar disa tabela korresponduese, që nevojiten për konvertim. Kjo punë duhet të vazhdojë dhe të përfundojë sa më shpejt që është e mundur, para misionit të radhës. Është krijuar një kornizë në Excel për SUT, ku mund të futen burimet e të dhënave kur bëhet konvertimi në klasifikimet e SUT.

Për shkak se ASN dhe statistikat PRODCOM nuk do të përfundojnë para mesit të Shtatorit 2015, plotësimi i anës ofruese në SUT nuk do të përfundojë derisa këto burime të rëndësishme të jenë në dispozicion. Përveç kësaj, është e rëndësishme, që stafi në ASK të ketë kohën e nevojshme për të përfunduar këto detyra. Në fillim të misionit të radhës të dhënat që mungojnë në anën ofruese duhet të vendosen së bashku dhe të gjitha inputet duhet të kthehen në një formë të standardizuar, që të jenë të gatshme të futen në kornizën Excel.

Balancimi i anës ofruese mund të fillojë pasi të jenë futur në sistem vlerat fillestare, por edhe kështu nuk është e shfrytëzueshme, derisa matrica e anës ofruese të fitojë një përmbajtje kredibile.

Akoma ka të dhëna, që mungojnë. Stafi i ASK duhet në veçanti të kërkojë informata për tregtinë e jashtme të shërbimeve dhe në shpërndarjen sipas produkteve të taksave dhe subvencioneve në produkte.

Para misioni të radhës, eksperti do të bëjë rregullimin e modeleve, që do të përdoren për kalkulimin e shpërndarjes të marzhave të tregtisë, taksave neto në produkte dhe TVSH-së.

Duke pasur parasysh disponueshmërinë e burimeve të të dhënave, duhet modifikuar orarin e propozimit për projekt.

Plani i rishikuar i aktiviteteve në vitin 2015/2016

	Koha	Çështjet më të rëndësishme
1	Mars 09-13, 2015	Misioni i gjetjes së fakteve
2	Qershor 22-26, 2015	Klasifikimet, tabelat korresponduese dhe kodimi i burimeve të dhënave. (ky mision)

3	Fillimi i Tetorit 2015	Ana ofruese sipas industrive dhe produkteve. Futja e të dhënave, shpërndarja e taksave, tregtia- dhe marzhat e transportit.
4	Fillimi i Nëntorit 2015	Balancimi i anës ofruese dhe përdoruese për secilin produkt.
5	Fundi i Nëntorit ose Fillimi i Dhjetorit 2015	Rregullimi i objektivave për inputet e industrisë dhe përdorimi final
6	Mesi ose Fundi i Janarit 2016	Balancimi final i marzhave, taksat dhe TVSH, ndarja e BVSH-së, tabela I-O simetrike.
7	Shkurti 2016	Çështjet e pazgjidhura. Prezantimi i versionit final të rezultateve. Propozimi për punën në të ardhmen.

Shumica e punës duhet të bëhet në periudhën midis misioneve dhe suksesi i projektit do të varet nga burimet, që janë në dispozicion në ASK për këtë projekt.

Burimet e të dhënave duhet të kthehen në një formë të standardizuar dhe të agregohen në klasifikimet SUT, para se të futen në kornizën SUT. Rekomandohet që futja e të dhënave fillestare të përfundojë para misionit të planifikuar për Nëntor. Disa çështje të pazgjidhura me siguri do të duhet të analizohen gjatë misionit.

Balancimi i balanceve të produkteve dhe balancimi final i marzhave të tregtisë, taksave dhe TVSH-së mund të kërkojë së paku dy misione, por një gjë e tillë varet nga cilësia e të dhënave, që futen fillimisht në sistem.

Pasi të përfundojë sistemi i balancuar e SUT, mund të përpilohet një tabelë simetrike e Inputit-Outputit. Kjo është planifikuar të fillojë në misionin, që do të mbahet në Janar.

Është e nevojshme që personat e angazhuar në projektin e përpilimit të SUT, të kenë në dispozicion kohën e nevojshme për këtë. Tashmë konsiderohet si plan joreal, që plotësimi i kornizës SUT me të dhëna mund të fillojë para Tetorit të vitit 2015.



Projekti i Binjakëzimit i BE-së

KS12 IB ST 01

Përkrahje për Statistikat

Termet e Referencës:

Komponenti 2: Llogaritë Kombëtare
Aktiviteti 2.6.1: Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit. Me fokus në SUT

Afatet:

Ter – data e finalizimit: 8 Qershor 2015

Fillimi / fund i aktivitetit: 22-26 Qershor 2015

Koha e raportimit: 3 Korrik 2015

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultatet obligative	Intervenimi logjik	Standardet	Burimet e informacionit	Supozimet
2.3.1	Përkrahja fillestare në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Vazhdim i përkrahjes në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare Përkrahja finale në implementimin e Planit të Veprimit për Llogaritë Kombëtare	- Raporti i misionit i publikuar në webfaqen e projektit - Fushat e selektuara të Llogarive Kombëtare të azhuruara sipas ESA 2010	- Raportet Tremujore të Projektit - Raportet e Misionit - Plani veprues i azhurnuar	- Kapacitet i mjaftueshëm i absorbimit - Numër i vogël i stafit i involvuar në implementim - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes të misioneve - Qasje në satistikat primare të qarta - Termet e references, të përpiluara me kohë, që paraqesin në detaje detyrat, (inputi), rezultat e pritura, pjesëmarrësit në aktivitet dhe agjendën

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: 2.6.1

Përkrahja në përpilimin e llogarive kombëtare në Kosovë. Fokus special në Tabelat ofruese-përdoruese (SUT). Ky mision është vazhdim i misionit 2.3.1.5 të Z. Larsen në Mars të vitit 2015. Gjatë misionit në Mars, që ka pasur për qëllim gjetjen e fakteve, është arritur në përfundim se është e mundur të përpilohen Tabelat Ofruese-Përdoruese (SUT) për LLogaritë Kombëtare në Kosovë. Për këtë qëllim, janë planifikuar gjashtë misione në kuadër të projektit:

1. Kodimi i të dhënave (ky mision)
2. Futja e të dhënave
3. Balancimi për secilin produkt
4. Rregullimi i objektivave të industrisë
5. Balancimi final, IO
6. Prezantimi i rezultateve

Rezultatet e pritura nga aktiviteti 2.6.1:

Raporti i misionit, që përshkruan rezultatet mbi kodimin e të dhënave, që do të përdoren për SUT

Rekomandimet për të ardhmen për SUT në ASK

Përshkrim i punës së bërë gjatë misionit dhe punës, që duhet të kompletohet para aktivitetit të radhës

Stafi i ASK:

Ilir.T. Berisha, Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarite Kombetare, Ilir.T.Berisha@rks-gov.net

Xhevdie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare, xhevriefetahu@gmail.com

Ylli Shala, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Ylli.Shala@rks-gov.net

Ilir Mazrekaj, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, ilir.mazrekaj@gmail.com

Emine Bajrami, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, alzana76@gmail.com

Florije Krapit, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Florije.Krapit@rks-gov.net,

Nysret Sylejmani, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, nysretsylejmani8@gmail.com

Besim Mehmeti, Zyrtar i lartë i Llogarive Kombëtare, Besim.Mehmeti@rks-gov.net

Have Kryeziu, Senior Officer of National Accounts, Have.Kryeziu@rks-gov.net

Andeta Krasniqi, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Andeta.Krasniqi@rks-gov.net

Kaltrina Veselaj, Zyrtare e lartë e Llogarive Kombëtare, Kaltrina.Veselaj@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Z. Søren Larsen, Ekspert i LLK, Statistikat e Danimarkës, shl@dst.dk

Stafi i Projektit të Binjakëzimit:

Z. Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Znj. Nora Zogaj, asistente, zogaj.nora@gmail.com

Përshkrimi i historikut për aktivitetet

Raporti i Vlerësimit të Adaptuar Global i vitit 2012 (AGA) i përgatitur nga Eurostat-i deklaroi në lidhje me Llogaritë Kombëtare (f. 53-54): Në vitin 2010, ASK, me mbështetjen e IPA, ka përgatitur një Plan veprimi për përpilimin dhe publikimin e statistikave të plota për llogaritë kombëtare dhe tregun e punës. Ky plan është në parim një instrument i dobishëm për organizimin dhe zhvillimin e ardhshëm të Llogarive Kombëtare së bashku me zhvillimin e standardeve dhe burimeve, që janë të nevojshme për rritjen e mbulueshmërisë dhe përmirësimin e të dhënave të llogarive kombëtare.

Projekti i Binjakëzimit tani më ka disa aktivitete në Komponentin #2 LLogaritë Kombëtare, përfshirë misionin e gjetjes së fakteve mbi SUT.

Gjatë misionit të kaluar është gjetur që është e mundur të krijohet SUT për Llogaritë Kombëtare në Kosovë. Ky mision do të fillojë me kodimin e të dhënave mbi bujqësinë dhe outputin dhe inputin e Qeverisë. Ky mision do të investigojë e dhe më tej gjendjen e të dhënave të ASN-së, që do të përdoren për SUT.

Aktivitetet që duhet të ndërmerren në përgatitje të misionit:

- Raportet e kaluara të misionit mbi komponentin e LLK në www.dst.dk/kosovo

Aktivitetet e pritura janë:

- Azhurnimi i planit të veprimit për përmirësimin e Llogarive Kombëtare me SUT
- Zhvillimi i mëtejshëm i planit të detajuar për veprimet e ardhshme mbi SUT, nga program i Binjakëzimit
- Ka filluar kodimi i të dhënave

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas mostrës
- Plani i detajuar për aktivitetet e ardhshme në komponentin 2 të projektit të binjakëzimit
- Plani i azhurnuar i aktiviteteve për SUT
- Lista e veprimeve, që duhet të ndërmerren para misionit të radhës

Aneksi 1. Programi – Qershor 2015

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	10:00	ASK: Rishikim i arritjeve që nga misioni i kaluar
		10:45	Pauza për kafe
		11:00	Diskutim i planeve për këtë javë
		12:00	Dreka
		13:30-15:30	Grumbullimi dhe kodimi i të dhënave
2	ASK	09:00-16:00	Grumbullimi dhe kodimi i të dhënave
3	ASK	09:00-16:00	Grumbullimi dhe kodimi i të dhënave
4	ASK	09:00-16:00	Grumbullimi dhe kodimi i të dhënave Diskutim mbi rekomandimet Plani për misionin e radhës dhe aktivitetet, që duhet të përfundohen para misionit të radhës Shkrimi i raportit
5	ASK	10:00-12:00	Shkrimi i raportit Takim mes ekspertëve, udhëheqësit të komponentit dhe RTA